



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/53

Datë: 16.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 Tetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/53

Datë: 16.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 Tetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave, për negocimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare "Modernizimi i shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës"
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/53

Datë: 16.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 Tetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave, për negocimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, mbi Bashkëpunimin dhe Ndihmën Reciproke në Çështjet Doganore.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/53

Datë: 16.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 Tetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik, i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Objektivit të Pikë-kalimit të përbashkët kufitar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, Zona Kadastrale Stançiq, Komuna e Gjilanit, bazuar në: Regjistrin në formë tabelare të pronarëve dhe të ngastrave kadastrale të cilat janë objekt i shpronësimit, certifikatat e njësive kadastrale dhe sipërfaqen e ngastrave kadastrale, si dhe në kopjet e planit, koordinatat e parcelave dhe pjesën grafike të vijës së shpronësimit, të përshkruara në tabelat e bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit, i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, dhe tabelat e bashkëngjitura këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas shkresës përcjellëse e Aktit të Vlerësimit Nr. Protokolli 4862/15 datë 28.09.2015.
5. Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike, kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë Gjykatës Kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit, të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar me këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Republikën e Kosovës.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/53

Datë: 16.10.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 Tetor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni ndërministror për Çështje të Komuniteteve në këtë përbërje:
 - 1.1. Branimir Stojanovic - Zëvendëskryeministër, Kryesues;
 - 1.2. Dalibor Jevtic - Ministër për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
 - 1.3. Ljubomir Maric - Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 1.4. Mahir Yagcilar - Ministër i Administratës Publike, anëtar;
 - 1.5. Avdullah Hoti - Ministër i Financave, anëtar;
 - 1.6. Blerand Stavileci - Ministër i Zhvillimit Ekonomik, anëtar;
 - 1.7. Rasim Demiri - Ministër pa portfolio, anëtar;
 - 1.8. Arban Abrashi - Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar dhe
 - 1.9. Ivan Tomic - Drejtor i Zyrës për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit, anëtar.
2. Komisioni ndërministror për Komunitete ka mandat ti shqyrtojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve.
3. Obligohet Komisioni ndërministror për Komunitete në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, legjislacionit në fuqi dhe Strategjisë për Komunitete dhe Kthim 2014 - 2018 të bëjë zbatimin e këtij vendimi.
4. Komisioni ndërministror do të bëjë koordinim më të mirë institucional në punën dhe implementimi e këtij vendimit, duke krijuar kushte më të mira për përfaqësuesit e komunitetit pakicë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventat Ndërkombëtare.
5. Komisioni ndërministror do të hartoj planin e veprimit të punës së tij, ndërsa kryesuesi i Komisioni ndërministror do të nxjerrë akte për mënyrën e funksionimit të Komisionit.
6. Zyra për Komunitete pranë Zyrës së Kryeministrit kryen funksionin e Sekretarisë teknike të Komisionit ndërministror për Komunitete.
7. Kryesuesi i Komisioni ndërministror është përgjegjës për thirrjen e takimeve të Komisionit.
8. Me qëllim të koordinimit më të mirë do të krijohen grupet punuese teknike.

9. Komisioni ndërministror merr vendime në qoftë se në mbledhje janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) të anëtarëve të Komisionit.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë